



Kosovo Property Claims Commission  
Komisioni i Kërkesave Pronësore të Kosovës  
Komisija Kosovske Agencije za Imovinu

Perandori Justinian 5  
Pristina  
Tel: +381 (0) 38 249-918  
Fax: +381 (0) 38 249-919  
E-mail: mailbox@kpaonline.org

## VENDIM

PANELI NR: 1

NR I VENDIMIT: KPCC/D/A/186/2013  
DATA E VENDIMIT: 13/02/2013

Komisionerët Heiskanen (Kryetar),  
Vokshi dhe Wühler.

## URDHËR

*(1) Në secilën prej 291 (dyqind e nëntëdhjetenjë) kërkesave të identifikuar në pjesët A, B, C dhe D të listës së bashkëngjitur, Komisioni*

*vendos që*

*Paraqitësi i kërkesës ose mbajtësi i së drejtës pronësore, sipas rastit, ka vërtetuar pronësinë për pronën e kërkuar, ose për atë pjesë të saj, ashtu si përcaktohet në vendimin individual përkatës;*

*(2) Në secilën prej 93 (nëntëdhjetetë) kërkesave të identifikuar në pjesën E të listës së bashkëngjitur, Komisioni*

*vendos që*

*Paraqitësi i kërkesës, ka vërtetuar pronësinë e mbajtësit të ndjerë të së drejtës pronësore për pronën e kërkuar, ose për atë pjesë të saj, ashtu si përcaktohet në vendimin individual përkatës;*

*(3) Në kërkesat nr. 23162 dhe 56537 të referuara në pjesën F të listës së bashkëngjitur, Komisioni,*

*vendos që*

*Paraqitësi i kërkesës ka vërtetuar të drejtën e shfrytëzimit për pjesën ideale prej 1/4 të pronës së kërkuar;*

- (4) Në secilën prej 386 (treqind e tetëdhjetegjashtë) kërkesave të referuara në paragrafin (1), (2) dhe (3) më sipër, përveç kërkesave nr. 11603, 11604, 13087, 31586, 31588, 31591, 31594, 31595, 31599, 31600, 31601, 51512, 92936 dhe 92937 Komisioni

*urdhëron që*

- (a) Paraqitësit të kërkesës apo bartësit e së drejtës pronësore, sipas rastit, t'i jepet posedimi i pronës së kërkuar;
  - (b) Çdo person i cili ka uzurpuar pronën në mënyrë të paligjshme, ta lirojë atë brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimi të këtij urdhri; dhe
  - (c) Nëse çdo person që ka uzurpuar pronën, i cili dështon të përmbushë urdhrin për lirimin e pronës brenda kohës së dhënë, të dëbohet nga prona;
- (5) Në kërkesat nr. 11603, 11604, 92936 dhe 92937 ku prona e kërkuar është e uzurpuar aktualisht nga KFOR-i i cili gëzon imunitet nga procedimi ligjor, Komisioni

*urdhëron që*

- (a) Paraqitësit të kërkesës apo bartësit e së drejtës pronësore, sipas rastit, t'i jepet posedimi i pronës së kërkuar pas lirimit nga KFOR-i;
  - (b) Çdo person tjetër përveç KFOR-it, i cili uzurpon pronën pas lirimit të saj nga KFOR-i, ta lirojë atë brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimi të këtij urdhri; menjëherë pas lirimit nga KFOR-i nëse kjo është më vonë; dhe
  - (c) Nëse çdo person, përveç KFOR-it, që ka uzurpuar pronën, i cili dështon të përmbushë urdhrin për lirimin e pronës brenda kohës së dhënë, të dëbohet nga prona; dhe
- (6) Në secilën kërkesë të përmendur në kolonat përkatëse në pjesët A, B, C, D dhe E të listës së bashkëngjitur, Komisioni më tutje vendos që kërkesat të hidhen poshtë kur paraqitësit e kërkesave kërkojnë kompensim për dëmin material apo për humbjen e shfrytëzimit të pronës së kërkuar.

## KORNIZA LIGJORE

1. Më 13 qershor 2008, në Kosovë ka hyrë në fuqi Ligji nr. 03/L-079 duke plotësuar dhe ndryshuar Rregulloren e UNMIK-ut 2006/50 mbi zgjidhjen e kërkesave që kanë të bëjnë me pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale. Ligji përmban një aneks ("Aneksi I") i cili plotëson dhe ndryshon Urdhëresën Administrative të UNMIK-ut nr. 2007/5, e cila zbaton Rregulloren e UNMIK-ut 2006/50. Me Ligjin nr. 03/L-079 dhe Aneksin I themelohet Agjencia Kosovare e Pronës ("AKP") si agjenci e pavarur, dhe ndryshohen dispozitat përkatëse të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 dhe Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 si të domosdoshme për të zbatuar ndryshimet në kornizën e aplikueshme ligjore. Në pajtueshmëri me dispozitat e tyre, Ligji nr. 03/L-079 dhe Aneksi I kanë hyrë në fuqi me publikimin e tyre në Gazetën Zyrtare.

2. Sipas nenit 22 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, Rregullorja pushoi së aplikuari me datën 31 dhjetor 2008. Prandaj, Ligji nr. 03/L-079 është aktualisht burimi i vetëm i autoritetit ligjor të Komisionit. Dispozitat e Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 vazhdojnë të mbesin relevante vetëm ashtu siç janë inkorporuar sipas Ligjit nr. 03/L-079.

### ARSYET PËR VENDIM

3. Paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, ka të drejtë në urdhër nga Komisioni për riposedim të pronës, nëse paraqitësi i kërkesës dëshmon:

- (a) pronësinë mbi pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale; ose
- (b) të drejtën e shfrytëzimit në lidhje me pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale,

ku paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, tani nuk mund të ushtrojë të drejta të tilla pronësore, dhe ku kërkesa përfshin rrethanat e ndërlidhura drejtpërsëdrejti me, apo që janë pasojë e konfliktit të armatosur që ka ndodhur në Kosovë mes 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999. (Shih nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 i plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-079.)

4. Kur paraqitësi i kërkesës paraqet kërkesë për pronësi në bazë të nenit 3.1(a) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079, Komisioni duhet ta zgjidhë çështjen e pronësisë dhe, nëse Komisionit i është dëshmuar pronësia dhe paraqitësi i kërkesës nuk e dëshmon të kundërtën, të jap urdhër për riposedim në dobi të paraqitësit të kërkesës apo bartësit të së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti. Kur paraqitësi i kërkesës paraqet kërkesë për të drejtën e shfrytëzimit të pronës në pajtim me nenin 3.1(b) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-079, Komisioni mund të shqyrtojë kërkesën me procedurë përmbledhëse dhe të lëshojë urdhër për kthimin e posedimit. (Shih nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, lexo bashkë me nenin 9 të Aneksit III të Urdhresës Administrative nr. 2007/5 të plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-079.)<sup>1</sup>

5. Komisioni mbajti seancën tridhjetetretë nga 11 nga 13 shkurt 2013 në Prishtinë. Komisionit i janë paraqitur gjithsej 690 kërkesa për pronë bujqësore në seancën e tridhjetetretë nga Sekretaria Ekzekutive e KPA-së ("Sekretaria Ekzekutive"), së bashku me dokumentacionin mbështetës, raportet e përpunimit të kërkesave, raportet e verifikimit, memorandumet ligjore dhe informata të tjera

<sup>1</sup> Duket se ka një gabim teknik në Aneksin I. Ndonëse në mënyrë të qartë paraqitet që Aneksi i kishte për qëllim të zëvendësonte në tërësi Urdhresën Administrative të UNMIK-ut 2007/5, përfshirë që të tri Aneksit e saj, Neni 26 i Aneksit i parasheh që e drejta nga Aneksi III i Urdhresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 duhet të zëvendësohet me të drejtën e cila referohet në Aneksin II. Megjithatë, nuk ka ndonjë dispozitë të veçantë apo ndonjë të dhënë tjetër në Ligjin 03/L-079 apo në Aneksit e tij që qëllimi i këtij ndryshimi të veçantë ishte të heq Aneksin I apo Aneksin II të Urdhresës Administrative të UNMIK-ut. Rrjedhimisht, Komisioni konsideron që të tri Aneksit e Urdhresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 janë përfshirë në pakon legislative dhe Komisioni do t'u referohet në këtë vendim si Nën-Aneksit I, II dhe III, respektivisht.

relevante. Një kërkesë për pronë bujqësore e cila iu paraqit Komisionit u tërhoq nga Sekretaria Ekzekutive gjatë seancës. Komisioni ndërpreu shqyrtimin e nëntë kërkesave për pronë bujqësore në pritje të mbajtjes të seancës dëgjimore. Përveç kësaj, Komisioni vendosi dhjetë kërkesa, të cilat ishin pezulluar më parë në pritje të mbajtjes së seancës dëgjimore. Gjithsej 690 kërkesa për pronë bujqësore u vendosën nga Komisioni gjatë seancës.

6. Në seancën e Komisionit, Sekretaria Ekzekutive i ka prezantuar kërkesat Komisionit dhe ka raportuar për përpunimin e kërkesave dhe çështjet ligjore dhe dëshmuese të cilat kanë rrjedhur nga kërkesat. Më kërkesë të Komisionit, Sekretaria Ekzekutive ka ofruar informata dhe sqarime shtesë, sipas nevojës.

#### *A. Kërkesa pronësore*

7. Në të gjitha kërkesat e përfshira në këtë vendim, përveç kërkesave nr. 23162 dhe 56537 ku paraqitësit e kërkesës kërkojnë konfirmimin e së drejtës së shfrytëzimit për pronat e kërkuara, paraqitësit e kërkesave kërkojnë zgjidhjen e kërkesës pronësore. Të gjitha kërkesat kanë të bëjnë me prona bujqësore, përfshirë arat, kullotat dhe pyjet.

8. Ky vendim trajton 386 kërkesa pronësore. Pjesa e mbetur prej 304 kërkesash për pronë bujqësore trajtohen në vendimet KPCC/D/A/187/2013 dhe KPCC/D/A/188/2013.

9. Gjithsej 272 nga 386 kërkesa të përfshira në këtë vendim nuk janë shqyrtuar më parë nga Komisioni, ndërsa 114 kërkesa kanë qenë subjekt i një vendimi të mëparshëm të Komisionit. Megjithatë, vendimi i mëparshëm në këto 114 është shfuqizuar nga Komisioni ose për shkak të notifikimit të pasaktë të pronave të kërkuara gjatë përpunimit të kërkesave nga Sekretaria Ekzekutive ose për shkak të gabimeve të përpunimit nga Sekretaria Ekzekutive të cilat janë identifikuar pasi është marrë vendimi. Për rrjedhojë, këto kërkesa duhet të rivendosen pas notifikimit të saktë të pronës së kërkuar dhe korrigjimit të gabimeve të përpunimit. Dëshmitë dhe informacioni i ofruar nga palët përgjegjëse në kërkesë ose uzurpuesit aktuale të pronave të kërkuara është marrë në konsideratë nga Komisioni në procesin e rivendosjes së kërkesave. Në kërkesat për të cilat vendimet e mëparshme janë shfuqizuar nga Komisioni, Sekretaria Ekzekutive i ka shkruar paraqitësit të kërkesës duke e informuar ata për gabimet e notifikimit dhe i ka informuar se kërkesa do të rivendoset pas notifikimit të saktë të pronës të kërkuar. Paraqitësit e kërkesës si dhe autoritetet e kadastrave përkatëse janë informuar se vendimet e mëparshme të Komisionit janë pavlerë dhe nuk mund të përdoren për qëllimet e çfarëdo transaksioni ligjor.

10. Komisioni vëren se të 386 kërkesat e përfshira në këtë vendim janë jokontestuese në kuptimin se në kohën e notifikimit të pronave të kërkuara nuk ka pasur dëshmi të uzurpimit të paligjshëm, të shfrytëzimit apo kultivimit të këtyre pronave nga ndonjë person ose, edhe kur ka pasur dëshmi të tilla, asnjë palë nuk ka kontestuar vlefshmërinë e kërkesës brenda periudhës prej 30 ditësh të paraparë në nenin 10.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 miratuar me Ligjin nr. 03/L-079, ose në një fazë të mëvonshme gjatë procedimit në bazë të nenit 10.3 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 miratuar me Ligjin nr. 03/L-079. Vendimet e marra për kërkesat që janë notifikuar pasaktësisht janë shfuqizuar nga Komisioni për të siguruar notifikimin e saktë e për t'i siguruar cilitdo personi i cili mund të ketë interes ligjor

për pronën, mundësinë për t'iu përgjigjur kërkesës në bazë të nenit 10.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079. Këto kërkesa janë identifikuar në kolonat përkatëse të listës së bashkangjitur vendimit. Sekretaria Ekzekutive ka notifikuar kërkesat në mënyra të ndryshme duke përfshirë notifikimin fizik të pronës, dhe/ose me anë të notifikimit të pronës përmes publikimit në gazeta zyrtare dhe gazeta, përmes autoriteteve vendore komunale, gjykatare vendore, udhëheqësve vendorë në fshat dhe institucioneve përkatëse në Kosovë dhe Serbi. Bazuar në informatat e ofruara nga Sekretaria Ekzekutive, Komisioni konstaton se Sekretaria Ekzekutive ka bërë përpjekje të arsyeshme për të notifikuar pronat e kërkuara, për të njoftuar personat të cilët aktualisht mund t'i kenë uzurpuar pronat, dhe persona tjerë të cilët mund të kenë interes ligjor në pronat e tilla, siç kërkohet nga neni 10.1 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 dhe neni 10.1 i Ligjit nr. 03/L-079. Në rastet kur prona e kërkuar nuk është notifikuar fizikisht, vendimi i Komisionit nuk cenon të drejtën e secilës palë të ndikuar nga ky vendim për të bërë ankesë ndaj këtij vendimi në bazë të nenin 10.3 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079 ashtu si përcaktohet nga Gjykata Supreme e Kosovës. Rrjedhimisht, këto kërkesa duhet të konsiderohen jokontestuese.

11. Në kërkesat e identifikuar në pjesët A, B, C, D, dhe E të listës së bashkëngjitur, Komisioni vëren se paraqitësit e kërkesave kanë paraqitur lloje të ndryshme të dokumenteve në mbështetje të kërkesave për pronësinë, përfshirë fletët poseduese, kontratat e përkujdesjes jetësore, vendimet e trashëgimisë, vendimet e gjykatës për njohjen e pronësisë, vendimet administrative dhe certifikatat për të drejtat e pronës së paluajtshme. Komisioni konstaton se vendimet e gjykatës së formës së prerë dhe certifikatat për të drejtat e pronës së paluajtshme që konfirmojnë interesin pronësor me të vërtetë përbëjnë dëshmi të pronësisë. Dokumentet e tjera të dorëzuara nga paraqitësit e kërkesave përfshirë fletët poseduese dhe kontratat që përfshijnë transaksione pronësore krijojnë një supozim të kundërshtueshëm të së drejtës pronësore. Kërkesat e përfshira në këtë vendim janë jokontestuese edhe nuk është marrë ose nuk është kërkuar *ex officio* nga Sekretaria asnjë provë që do të kundërshtonte supozimin e të drejtës pronësore. Rrjedhimisht, Komisioni konstaton faktin se dokumentet e dorëzuara provojnë të drejtën pronësore të paraqitësve të kërkesave për pronat e kërkuara. Dokumentet janë verifikuar nga Sekretaria Ekzekutive si të vlefshme dhe konsiderohen si relevante. Shumë paraqitës të kërkesave kanë paraqitur gjithashtu dokumente mbështetëse shtesë përfshirë vendime të taksave, deklarata të dëshmitarëve, kopje të planeve dhe vendimeve kadastrale.

12. Në 94 kërkesat e identifikuar në pjesën A të listës së bashkëngjitur, paraqitësit e kërkesave kanë depozituar kërkesë në cilësinë e bartësit të së drejtës pronësore. Në bazë të konstatimeve të Komisionit në paragrafin 11 më sipër, të gjitha këto kërkesa duhet të miratohen.

13. Në 71 kërkesat e identifikuar në pjesën B të listës së bashkëngjitur, paraqitësit e kërkesave kanë paraqitur kërkesën në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të bartësit të së drejtës pronësore në bazë të nenit 1.2 të Aneksit II të Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 e miratuar me Ligjin Nr. 03/L-079. Neni 1 i Urdhërësës Administrative i miratuar me Ligjin Nr. 03/L-079 përcakton që si “Anëtar i Bashkësisë Familjare” përfshihen “bashkëshorti/ja, fëmijët (të lindur brenda dhe jashtë martesës ose të adoptuar) dhe personat tjerë të cilët bartësi i së drejtës pronësore është i obliguar t'i mbështesë në pajtim me ligjin e aplikueshëm apo personat që janë të obliguar ta mbështesin bartësin e së drejtës pronësore në pajtim me ligjin e aplikueshëm pavarësisht nëse ata persona kanë banuar apo jo në pronë së

bashku me bartësin e së drejtës pronësore.” Komisioni ka përcaktuar se, sipas ligjit të aplikueshëm, ky përkufizim përfshin përveç bashkëshortëve dhe fëmijëve gjithashtu edhe prindërit, vëllezërit, motrat, gjyshërit, nipat/mbesat, stërgjyshërit, stërnipat/stërmbesat e bartësit të së drejtës pronësore. Të gjithë paraqitësit e kërkesave në kërkesat e regjistruara në pjesën B të listës së bashkëngjitur përfshihen në përkufizimin e anëtarit të bashkësisë familjare. Rrjedhimisht, vendimi i cili konfirmon të drejtën pronësore në favor të bartësit të së drejtës pronësore duhet të aprovohet në secilën kërkesë të regjistruar në pjesën B të listës së bashkëngjitur, siç është dhënë më sipër. Në kërkesat e regjistruara në kolonën përkatëse të pjesës B të listës së bashkëngjitur, paraqitësi i kërkesës pretendon se bartësi i së drejtës pronësore ka vdekur, por nuk ka paraqitur asnjë dëshmi të dokumentuar e cila do të dëshmonte vdekjen, dhe as Sekretaria Ekzekutive nuk ka mundur të gjejë ndonjë dokument të tillë. Rrjedhimisht, vendimi i cili konfirmon të drejtën pronësore në favor të bartësit të së drejtës pronësore duhet të aprovohet gjithashtu në secilën nga këto kërkesa, siç është dhënë më sipër.

14. Në pesë kërkesat e përfshira në pjesën C të listës së bashkëngjitur, bartësi i së drejtës pronësore përfaqësohet nga një person fizik i autorizuar. Komisioni ka vendosur që individi i autorizuar posedon autorizim të vlefshëm të bërë sipas rregullit në bazë të nenit 5.2 të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079. Rrjedhimisht, duhet të miratohet vendimi për konfirmimin e të drejtës pronësore në dobi të bartësit të së drejtës pronësore në lidhje me këto kërkesa.

15. Në 121 kërkesat e identifikuara në pjesën D të listës së bashkëngjitur, paraqitësi i kërkesës apo bartësi aktual i së drejtës pronësore, sipas rastit, nuk ka qenë bartës i së drejtës pronësore në datën e humbjes së posedimit të pronës së kërkuar, por ka ofruar dëshmi se më pas e ka trashëguar të drejtën përkatëse të pronësisë përmes trashëgimisë, kontratës së dhurimit apo kontratës së shitblerjes, siç mund të jetë rasti. Paraqitësi i kërkesës apo bartësi aktual i së drejtës pronësore, sipas rastit, duhet të konsiderohet si person i cili ka trashëguar të gjitha të drejtat të cilat i takojnë një pronari, qoftë si bashkëpronar ose pronar i vetëm i pronës në bazë të dokumentit të verifikuar që provon trashëgiminë e tillë e përcaktuar në pjesën ideale të pronës së kërkuar. Kjo e drejtë trashëgimore përfshin të drejtën për të kërkuar konfirmimin e pronësisë ose bashkëpronësisë, sipas rastit dhe riposëdimin në këtë procedim. Këto kërkesa duhet të aprovohen, siç është dhënë më sipër. Në kërkesat e përmendura në kolonën përkatëse të kësaj pjese D të listës së bashkëngjitur, kërkesat janë paraqitur ose nga anëtari i bashkësisë familjare ose nga përfaqësuesi i autorizuar që vepron në emër të bartësit të së drejtës pronësore. Komisioni përcakton se paraqitësit e kërkesave në këto raste janë ose anëtarë të bashkësisë familjare të bartësit aktual të së drejtës pronësore në kuptim të nenit 1 të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5, miratuar me Ligjin nr. 03/L-079 ose janë bartës aktualë të së drejtës pronësore që kanë përfaqësues të autorizuar të cilët posedojnë autorizim të vlefshëm të bërë sipas rregullit në bazë të nenit 5.2 të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 miratuar me Ligjin nr. 03/L-079, për të paraqitur kërkesë në emër të tyre.

16. Në 93 kërkesat e përmendura në pjesën E të listës së bashkëngjitur, paraqitësi i kërkesës nuk ka qenë bartës i së drejtës pronësore në datën e humbjes së posedimit të pronës së kërkuar, por pohon të ketë trashëguar pronën. Në secilën nga këto kërkesa, paraqitësi i kërkesës ka dëshmuar se ai apo ajo është anëtar i bashkësisë familjare të bartësit të ndjerë të së drejtës pronësore. Megjithatë, nuk është paraqitur vendim i vlefshëm për trashëgiminë apo ndonjë dëshmi tjetër e dokumentuar nga paraqitësit e

kërkesave, i cili do të vërtetonte që ndonjëri nga paraqitësit e kërkesave të jetë trashëgimtar i pronës së kërkuar, dhe as Sekretaria Ekzekutive nuk ka mundur të gjejë ndonjë dokument të tillë. Disa paraqitës të kërkesave, kanë paraqitur si prova “vendime të trashëgimisë” të lëshuara posaçërisht nga gjykatat paralele në Serbi. Komisioni nuk konsideron që dokumentet e tilla mund të vërtetojnë të drejtën e trashëgimisë. Komisioni nuk ka juridiksion të zgjidhë çështjet që kanë të bëjnë me trashëgiminë. Rrjedhimisht, vendimi i cili konfirmon të drejtën pronësore në favor të bartësit të ndjerë të së drejtës pronësore duhet të aprovohet në secilën nga këto kërkesa, siç është dhënë më sipër. Vendimi i Komisionit sa i përket të gjitha kërkesave të përmendura në këtë pjesë E të listës së bashkëngjitur, nuk cenon vendimin e gjykatave kompetente për mënyrën se si trashëgimtarët do të trashëgojnë të drejtën pronësore nga i ndjeri. Në kërkesat e regjistruara në kolonën përkatëse të kësaj pjese E të listës së bashkëngjitur, anëtari i bashkësisë familjare i bartësit të ndjerë të së drejtës pronësore është përfaqësuar nga personi fizik i autorizuar me autorizim. Komisioni ka përcaktuar se në secilin nga këto raste personi i autorizuar fizik posedon autorizim të vlefshëm të bërë sipas rregullit nga anëtari i bashkësisë familjare i bartësit të ndjerë të së drejtës pronësore sipas nenit 5.2 të Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 miratuar me Ligjin nr. 03/L-079. Rrjedhimisht, duhet të aprovohet vendim për konfirmimin e së drejtës pronësore në favor të bartësit të ndjerë të së drejtës pronësore në secilën nga këto raste.

*B. Kërkesa për te drejtën e shfrytëzimit*

17. Në kërkesën nr. 56537 dhe 23162 të referuar në pjesën F të listës së bashkëngjitur, paraqitësit e kërkesës, në cilësinë e mbajtësve të pretenduar të së drejtës së shfrytëzimit, kërkojnë konfirmimin e së drejtës së shfrytëzimit në pjesën ideale prej  $\frac{1}{4}$  të pronës respektive së kërkuar. Në mbështetje të kërkesës, paraqitësi i kërkesës në kërkesën nr. 23162 ka paraqitur fletën poseduese, të verifikuar pozitivisht, dhe paraqitësi i kërkesës në kërkesën nr. 56537 ka paraqitur certifikatën për të drejtat e pronës së paluajtshme, të verifikuar pozitivisht e cila e tregon paraqitësin përkatës të kërkesës si mbajtës më të drejta të plota të së drejtës së shfrytëzimit për pjesën ideale prej  $\frac{1}{4}$  të pronës së kërkuar. Bazuar në dëshmitë para tij, Komisioni konstaton se kërkesat duhet të miratohen.

\*\*\*\*

18. Llojet e ndryshme të dokumenteve në të cilat janë mbështetur paraqitësit e kërkesave në përkrahje të kërkesave të cekura më sipër janë të regjistruara në kolonat përkatëse të pjesëve A, B, C, D dhe E.

19. Bazuar në dëshmitë para tij, Komisioni konstaton se humbja e së drejtës pronësore në secilin rast të përfshirë në këtë vendim, ka ndodhur në rrethanat e ndërlidhura drejtpërsëdrejti ose që kanë rezultuar nga konflikti i armatosur që ka ndodhur në Kosovë midis 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999, ashtu si kërkohet nga neni 3 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079.

20. Në një numër kërkesash, paraqitësit e kërkesave apo bartësit e së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, janë larguar nga prona jashtë periudhës prej 27 shkurtit 1998 deri më 20 qershor 1999, e cila parashihet në nenin 3 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 miratuar me Ligjin nr. 03/L-079. Komisioni ka përcaktuar që, ndonëse data e largimit në këto kërkesa është jashtë periudhës së mësipërme, humbja e së drejtës pronësore në secilin rast është rezultat i rrethanave që ndërlidhen

drejtpërsëdrejti me, apo që janë pasojë e konfliktit të armatosur që ka ndodhur në Kosovë mes 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999, siç kërkohet me nenit 3 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 miratuar me Ligjin nr. 03/L-079.

21. Në kërkesat nr. 31586, 31588, 31591, 31594, 31595, 31599, 31600 dhe 31601 të referuara në kolonën përkatëse të listës së bashkangjitur, paraqitësi i kërkesës kërkon të drejtën pronësore për pronat e kërkuara pa urdhër dëbimi duke deklaruar se është në negociata me shfrytëzuesin e tanishëm të pronave të kërkuara për t'ia shitur pronat atij. Në kërkesat nr. 13087 dhe 51512 të referuara në kolonën përkatëse të listës së bashkangjitur, paraqitësi i kërkesës deklaron se mbajtësi i pretenduar i së drejtës pronësore ka rimarrë posedimin e pronave të kërkuara pas konfliktit të 1998-99 dhe tani prona e kërkuar është në shfrytëzim të familjes se mbajtësit të së drejtës pronësore. Në këto rrethana, duhet të miratohet urdhër për konfirmimin e së drejtës pronësore për paraqitësin e kërkesës, pa urdhër dëbimi ose ndonjë formë tjetër të mjetit ligjor ndihmës, ashtu si përcaktohet më sipër.

22. Në kërkesat nr. 11603, 11604, 92936 dhe 92937 prona e kërkuar është tani e uzurpuar nga KFOR-i, i cili sipas Rregullores së UNMIK-ut 2000/47 gëzon imunitet nga procedimi ligjor. Komisioni konsideron se këto kërkesa, kur ato kërkojnë konfirmimin e pronësisë janë *in rem* dhe për rrjedhojë miratimi i tyre nuk cenon imunitetin e gëzuar nga KFOR-i. Sekretaria Ekzekutive është konsultuar informalisht me KFOR-in, i cili mesa duket, nuk kundërshton në këtë aspekt. Megjithatë, imuniteti që gëzon KFOR-i nuk e lejon Komisionin të nxjerrë urdhër dëbimi kundër KFOR-it si uzurpator i tanishëm i pronës së kërkuar. Rrjedhimisht urdhri i dëbimit në kërkesat e lartpërmendura zbatohet vetëm ndaj palëve të treta të cilat mund të uzurpojnë në mënyrë të paligjshme pronat e kërkuara pas lirimit të tyre nga KFOR-i.

23. Nga sa u tha më sipër, Komisioni bazuar në dëshmitë që i posedon, konstaton se në secilën nga kërkesat e përfshira në këtë vendim:

- (a) paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, ka të drejtën e pronësisë ose të shfrytëzimit, sipas rastit, në lidhje me pronën e kërkuar, apo pjesën e tillë siç është specifikuar në vendimin përkatës individual;
- (b) kërkesa është jokontestuese në kuptimin se asnjë person nuk e ka kontestuar vlefshmërinë e kërkesës;
- (c) paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, sipas rastit, në secilin rast tani nuk mund të ushtrojë të drejtën e tij apo të saj të pronësisë; dhe
- (d) kërkesa në secilin rast përfshinë rrethanat e ndërlydhura drejtpërsëdrejti apo që janë pasojë e konfliktit të armatosur që ka ndodhur mes 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999.

### C. *Kërkesa për kompensim*

24. Në kërkesat e përmendura në kolonat përkatëse të pjesëve A, B, C, D dhe E të listës së bashkëngjitur, paraqitësit e kërkesave gjithashtu kërkojnë, përveç pronësisë, kompensimin për dëmin material apo humbje të shfrytëzimit, të pronës së kërkuar. Sipas Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 miratuar me Ligjin Nr. 03/L-079, Komisioni

nuk ka juridiksion për kërkesat e tilla. Rrjedhimisht, këto kërkesa duhet të hidhen poshtë.

*D. Vërejtjet përmbledhëse*

25. Nga sa u tha më sipër, Komisioni konstaton se kërkesat e regjistruara në pjesët A, B, C, D dhe E të listës së bashkëngjitur janë të suksesshme dhe udhëzon të nxirret urdhri sa i përket secilës kërkesë ashtu siç është dhënë më sipër.

26. Në një numër kërkesash, paraqitësi i kërkesës kishte paraqitur kërkesë për riposedit të pronës së njëjtë në Drejtoratin për Çështje Pronësore dhe Banesore, e cila kërkesë më pastaj ishte aprovuar nga Komisioni për Kërkesa Pronësore dhe Banesore ("HPCC"). Komisioni konstaton se mjetet e veprimit në dispozicion të paraqitësve të kërkesave para Komisionit aktual dhe HPCC-së, respektivisht, dhe, rrjedhimisht edhe juridiksioni i dy Komisioneve, nuk janë të njëjta. Kështu, vendimet e HPCC-së nuk mund të jenë domosdoshmërisht *res judicata* para Komisionit aktual, megjithatë në rrethana të caktuara mund të kemi të bëjmë me një rast të tillë. Për më tepër, në rastet kur HPCC-ja ka aprovuar urdhrin për dëbim në favor të paraqitësit të kërkesës, Komisioni nuk konsideron se një urdhër i tillë paraqet pengesë për këtë Komision që të lëshojë urdhër të ri për dëbim në rastet kur prona është e uzurpuar në mënyrë të paligjshme.

27. Vendimet dhe urdhri i mësipërm i Komisionit gjithashtu aplikohen, ku është e përshtatshme edhe për çdo pronë të bashkuar, d.m.th. për çdo ndërtesë ose ndërtim tjetër të zotëruar apo të shfrytëzuar nga paraqitësi i kërkesës ose bartësi i së drejtës pronësore, sipas rastit, të cilat formojnë një njësi me pronën e kërkuar.

28. Në bazë të nenit 8.5 të aneksit III të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079, Komisioni mundet të vendosi në vendimin e tij për të drejtën pronësore në emër të bartësit të së drejtës pronësore edhe të nxjerrë urdhër për posedimin në dobi të paraqitësit të kërkesës. Kur bartësi i së drejtës pronësore është i gjallë, Komisioni miraton të drejtën e posedimit në emër të bartësit të së drejtës pronësore. Në rastet kur bartësi i së drejtës pronësore ka vdekur e vdekja është provuar por nuk është siguruar vendim i vlefshëm për trashëgiminë, Komisioni miraton posedimin për paraqitësin e kërkesës si anëtar i bashkësisë familjare të bartësit të së drejtës pronësore. Në rastet kur mbajtësi i së drejtës pronësore ka vdekur pas depozitimit të kërkesës dhe nuk ka anëtar të bashkësisë familjare të mbajtësit të së drejtës pronësore, Komisioni miraton të drejtën e posedimit për mbajtësin e ndjerë të së drejtës pronësore. E drejta e posedimit miratohet në bazë të dispozitave të ligjit në fuqi që rregullon marrëdhëniet familjare në Kosovë, i cili përfshin administrimin e pronës familjare si dhe duke iu referuar ligjit në fuqi për trashëgiminë. Vendimi i Komisionit për të drejtën e posedimit të pronës nga paraqitësi i kërkesës si anëtar i bashkësisë familjare nuk cenon të drejtën e anëtarëve të tjerë të bashkësisë familjare, ose trashëgimtarëve të tjerë, të bartësit të së drejtës pronësore të cilët nuk kanë depozituar kërkesë në KPA, por të cilët mund të kenë të drejtë të përbashkët për posedimin e pronës në bazë të ligjit në fuqi ose si rrjedhojë e procedimit për trashëgiminë në të ardhmen. (neni 8.5 i aneksit III të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 miratuar me Ligjin nr. 03/L-079).

29. Neni 8.8 i Aneksit III të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut nr. 2007/5 i miratuar me Ligjin 03/L-079 lejon Kryetarin e Komisionit të nënshkruajë vendimin grupor duke aprovuar të gjitha kërkesat individuale të identifikuara në vendimin grupor,

nëse numri i kërkesave të vendosura gjatë seancës është i lartë. Komisioni konsideron se kjo është e përshtatshme në rastin konkret.



Kryetari

#### ANKESAT

Rregullorja e UNMIK-ut 2006/50 dhe Ligji Nr. 03/L-079 parashohin që:

12.1 Brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga njoftimi i palëve nga Agjencia Kosovare e Pronës për vendimin e Komisionit mbi kërkesën, pala mund të paraqesë ankesë ndaj vendimit të tillë në Gjykatën Supreme të Kosovës përmes Sekretarisë Ekzekutive të Agjencisë Kosovare të Pronës.

12.3 Ankesa mund të paraqitet duke u bazuar në atë se:

- (a) Vendimi përmban gabim thelbësor apo moszbatim serioz të ligjit material apo procedural; apo
- (b) Vendimi mbështetet në vlerësim të gabuar apo të mangët të fakteve.

Gjykata Supreme e Kosovës mund të vjelë tarifën e gjyqësore për procedurën e ankesës.

Informacione lidhur me procedurën e ankesave gjenden në fletën informuese për ankesën e cila u ofrohet palëve së bashku me vendimin.

**\* Versioni në gjuhën angleze është versioni zyrtar i të gjitha vendimeve të Komisionit për Kërkesa Pronësore. Në rast të mospërputhjes mes versionit në gjuhën angleze dhe versionit në gjuhën shqipe apo serbe, atëherë mbizotëron versioni në gjuhën angleze.**

Spreadsheet /Lista /Prilog  
Part A/Pjesa A/Deo A

|                 |          |          |          |          |          |                 |
|-----------------|----------|----------|----------|----------|----------|-----------------|
| KPA00311        | KPA00855 | KPA10397 | KPA19151 | KPA23098 | KPA25293 | KPA39049        |
| KPA90186        | KPA90630 | KPA90631 | KPA91774 | KPA92673 | KPA92696 | KPA92740        |
| KPA00216        | KPA01344 | KPA13350 | KPA13356 | KPA13460 | KPA25294 | KPA22329<br>REP |
| KPA23572<br>REP | KPA27256 | KPA27257 | KPA36743 | KPA39157 | KPA45210 | KPA47077        |
| KPA51788        | KPA13505 | KPA15392 | KPA17516 | KPA17768 | KPA26637 | KPA28075        |
| KPA28665        | KPA30748 | KOA36784 | KPA39083 | KPA50412 | KPA90659 | KPA92869        |
| KPA10774        | KPA10775 | KPA26615 | KPA26264 | KPA27255 | KPA37853 | KPA42015        |
| KPA44736        | KPA49098 | KPA92689 | KPA10727 | KPA23296 | KPA28303 | KPA28307        |
| KPA28311        | KPA28513 | KPA48489 | KPA91808 | KPA51540 | KPA01037 | KPA06263        |
| KPA10577        | KPA14296 | KPA14297 | KPA14834 | KPA14835 | KPA14840 | KPA15910        |
| KPA18025        | KPA18314 | KPA20190 | KPA20192 | KPA20195 | KPA20197 | KPA22642        |
| KPA22929        | KPA24788 | KPA24791 | KPA25280 | KPA30823 | KPA38393 | KPA40816        |
| KPA40817        | KPA40818 | KPA40819 | KPA40820 | KPA40842 | KPA41006 | KPA41007        |
| KPA41008        | KPA48638 | KPA48641 |          |          |          |                 |

Spreadsheet /Lista /Prilog  
Part B/Pjesa B/Deo B

|          |          |          |          |          |          |          |
|----------|----------|----------|----------|----------|----------|----------|
| KPA13192 | KPA14515 | KPA17910 | KPA27166 | KPA27291 | KPA30670 | KPA50874 |
| KPA51512 | KPA51718 | KPA52293 | KPA53963 | KPA56427 | KPA90128 | KPA25026 |
| KPA25027 | KPA25028 | KPA25030 | KPA25031 | KPA25032 | KPA25033 | KPA25034 |
| KPA25035 | KPA25036 | KPA06990 | KPA16083 | KPA14437 | KPA14776 | KPA14777 |
| KPA24956 | KPA27167 | KPA27168 | KPA27169 | KPA27170 | KPA27171 | KPA90743 |
| KPA24946 | KPA27165 | KPA36462 | KPA38920 | KPA38921 | KPA38924 | KPA38925 |
| KPA38926 | KPA47120 | KPA47363 | KPA92925 | KPA15562 | KPA17627 | KPA44369 |
| KPA90444 | KPA90635 | KPA92306 | KPA92851 | KPA92853 | KPA92855 | KPA92856 |
| KPA92857 | KPA92858 | KPA06840 | KPA17807 | KPA17845 | KPA20235 | KPA30677 |
| KPA39039 | KPA91891 | KPA27011 | KPA27012 | KPA27015 | KPA27021 | KPA48502 |
| KPA48503 |          |          |          |          |          |          |

Spreadsheet /Lista /Prilog  
Part C/Pjesa C/Deo C

|          |          |          |          |          |  |  |
|----------|----------|----------|----------|----------|--|--|
| KPA11603 | KPA11604 | KPA92890 | KPA92936 | KPA92937 |  |  |
|----------|----------|----------|----------|----------|--|--|

Spreadsheet /Lista /Prilog  
Part D/Pjesa D/Deo D

|          |          |          |          |          |          |          |
|----------|----------|----------|----------|----------|----------|----------|
| KPA92891 | KPA92892 | KPA92893 | KPA92894 | KPA92895 | KPA92896 | KPA92897 |
| KPA92898 | KPA92899 | KPA92900 | KPA92901 | KPA92902 | KPA92906 | KPA92907 |

|                 |                 |                 |                 |                 |                 |                 |
|-----------------|-----------------|-----------------|-----------------|-----------------|-----------------|-----------------|
| KPA92908        | KPA92909        | KPA92910        | KPA92911        | KPA92912        | KPA92913        | KPA92914        |
| KPA10674        | KPA13085        | KPA13087        | KPA24796        | KPA25283<br>REP | KPA25286<br>REP | KPA26019<br>REP |
| KPA27254        | KPA28036        | KPA31625        | KPA33865        | KPA34161<br>REP | KPA39676        | KPA15327        |
| KPA22114<br>REP | KPA22161<br>REP | KPA22162<br>REP | KPA22163<br>REP | KPA24179        | KPA24187<br>REP | KPA24190        |
| KPA27253        | KPA92729        | KPA14621        | KPA14622        | KPA22842        | KPA30639<br>REP | KPA30641<br>REP |
| KPA30642<br>REP | KPA35271<br>REP | KPA35320<br>REP | KPA35321<br>REP | KPA35325<br>REP | KPA91857        | KPA92888        |
| KPA92889        | KPA35703<br>REP | KPA35705<br>REP | KPA35706        | KPA92927        | KPA92928        | KPA92929        |
| KPA92930        | KPA92931        | KPA92932        | KPA92945        | KPA92946        | KPA92947        | KPA92948        |
| KPA92949        | KPA92950        | KPA16390<br>REP | KPA16391        | KPA16392        | KPA27432        | KPA37272        |
| KPA35327        | KPA92723        | KPA92724        | KPA92725        | KPA92852        | KPA92854        | KPA92859        |
| KPA92860        | KPA92861        | KPA92862        | KPA17027        | KPA23891<br>REP | KPA31586<br>REP | KPA31588<br>REP |
| KPA31591<br>REP | KPA31594<br>REP | KPA31595<br>REP | KPA31599<br>REP | KPA31600<br>REP | KPA31601<br>REP | KPA90052        |
| KPA31628        | KPA31637        | KPA40887<br>REP | KPA44620        | KPA91415        | KPA91754<br>REP | KPA51639        |
| KPA06417        | KPA06419        | KPA06872        | KPA07374        | KPA07387        | KPA07393        | KPA07411        |
| KPA10029        | KPA10033        | KPA10465        | KPA11500        | KPA20154        | KPA26768        | KPA28278        |
| KPA50506        | KPA56152        |                 |                 |                 |                 |                 |

Spreadsheet /Lista /Prilog  
Part E/Pjesa E/Deo E

|          |          |                 |                 |                 |                 |                 |
|----------|----------|-----------------|-----------------|-----------------|-----------------|-----------------|
| KPA11017 | KPA11386 | KPA11387        | KPA15273        | KPA20005        | KPA25904        | KPA25915        |
| KPA25917 | KPA25996 | KPA48958<br>REP | KPA50029        | KPA53664        | KPA53766<br>REP | KPA53982        |
| KPA91786 | KPA07050 | KPA11018        | KPA11780        | KPA14097        | KPA14477        | KPA17678        |
| KPA18004 | KPA18005 | KPA18006        | KPA20004        | KPA51545<br>REP | KPA91333        | KPA92679        |
| KPA92944 | KPA01413 | KPA14002        | KPA14739        | KPA15237        | KPA17715        | KPA17716        |
| KPA21537 | KPA21538 | KPA21539        | KPA90555        | KPA08793        | KPA08795        | KPA08796        |
| KPA28754 | KPA31621 | KPA37706        | KPA37707        | KPA37708        | KPA48505        | KPA50834<br>REP |
| KPA52065 | KPA54041 | KPA06290        | KPA06296        | KPA06300        | KPA21320        | KPA06303        |
| KPA06304 | KPA29719 | KPA29722        | KPA06422<br>REP | KPA06423<br>REP | KPA23921        | KPA23930        |
| KPA35831 | KPA37253 | KPA37254        | KPA37255        | KPA37256        | KPA39776        | KPA43250        |

|                 |                 |          |          |          |          |          |
|-----------------|-----------------|----------|----------|----------|----------|----------|
| KPA50829<br>REP | KPA50832<br>REP | KPA50842 | KPA06647 | KPA08896 | KPA16095 | KPA17977 |
| KPA17982        | KPA17984        | KPA26215 | KPA26266 | KPA32412 | KPA33353 | KPA36773 |
| KPA36775        | KPA36959        | KPA36959 | KPA43082 | KPA43083 | KPA43084 | KPA44047 |
| KPA45318        |                 |          |          |          |          |          |

Spreadsheet /Lista /Prilog  
Part F/Pjesa F/Deo F

|          |  |  |  |  |  |  |
|----------|--|--|--|--|--|--|
| KPA23162 |  |  |  |  |  |  |
| KPA56537 |  |  |  |  |  |  |